Generican Pharma

# Lisinocomp

LISINOCOMP GENERICON (Lisinopril + hidroklorotiazid ) PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Lisinopril në formë dihidrati dhe hidroklorotiazid VEPRIMI: Lisinoprili është inhibitor i enzimës angjiotenzinkonvertazë, me përmbajtje kimike të ngjashme me enalaprilin. Krahasuar me kaptoprilin dhe enalaprilin përthithet më ngadalë, vepron më gjatë dhe merret si dozë e vetme ditore. Komponenta tjetër e barit, hidroklortiazidi është diuretik tiazidik, i cili nuk ka ndikim në persionin arterial normal, por, në gjendjet hipertenzive, ai ul presionin e rritur të gjakut. Efekti antihipertenziv i këtij medikamentit shfaqet pas 1-2 orësh dhe zgjat rreth 24 orë. Indikacionet : Hipertensioni arterial, dema, e shkaktuar nga insuficienca kardiake, renale apo ajo hepatike KUNDËRINDIKACIONET: Hipersensitiviteti ndaj përbërësve të medikamentit ose ndaj sulfonamideve, Nese pacienti ka vuajtur nga edema angjioneurotike e shkaktuar nga ndonjë, ACE inhibitorë ose substancë tjetër, Mungesë urinimi ose përkeqësim i rendë i funksionimit të veshkave, Stenoza e arteries renale, Shtatzënia dhe gjidhënia, Fëmijët. EFEKTET ANËSORE TË MUNDËSHME: Hipotension arterial, dhimbje koke, marrje mendësh, kollë e thatë, lodhje, tharje e gojës, neveri, dhimbje barku, diare, probleme me tretjen e ushqimit. DOZIMI DHE MËNYRA E PËRDORIMIT: Doza normale është: i tabletë Lisinocomp semi (10+12.5mg) në ditë. Nëse veprimi është i pamjaftueshëm atëhere mund të ordinohet Lisinocomp mite (20+12.5mg) ose Lisinocomp (20+25mg) tableta. Tabletat mund të merren me ujë para, gjatë ose pas ngrënies.








**Përfaqësues Ekskluziv për Kosovë:**

Pharma plus

**Pharmaplus**
Rr. "28 Nëntori"
Qendra Tregtare te PTK
Tel/Fax: 038 551 001
Email: pharmaplusllc@gmail.com

Genericon Pharma

# Lisinocomp Genericon

## Forma farmaceutike dhe doza

Lisinocomp "Genericon" tableta
(Lisinopril 20 mg + Hydrochlorothiazide 25 mg)

Lisinocomp "Genericon" mite tableta
(Lisinopril 20 mg + Hydrochlorothiazide 12,5 mg)

Lisinocomp "Genericon" semi tableta
(Lisinopril 10 mg + Hydrochlorothiazide 12,5 mg)

## Përparësitë klinike për përdorimin e Lisinocomp "Genericon"

- Efikas në mjekimin e sëmundjeve të ndryshme kardiovaskulare (hipertensioni,insuficienca kongjestive e zemrës, hipertensioni renovaskular)
- Zvogëlon shkallën e morbiditetit dhe mortalitetit te pacientët me infarkt miokardi
- Kontrolla në mënyrë të vazhdueshme e shtypjes së gjakut në periudhë prej 24 orëve

## Indikacionet

- Hipertensioni esencial dhe renovaskular si monoterapi ose në kombinim me barna tjera antihipertenziv
- Insifucienca kongjestive e zemrës, si terapi shtesë me barnat diuretike ose sipas nevojës edhe digitalisit
- Infarkti akut I miokardit (në afat brenda 24 orëve)
- Nefropatia diabetike

## Dozimi

| Indikacionet | Doza fillestare | Doza e mbajtjes | Doza max. |
|---|---|---|---|
| Hipertensioni esencial | 1 x 10 mg | 1 x 20 mg | <80 mg |
| Hipertensioni renovaskular | 1 x 2.5 – 5mg | 1 x 20 mg | <80 mg |
| Insuficienca e zemrës | 1 x 2.5 mg | 1 x 5 – 40 mg | <80 mg |
| Pas infaktit të mikoardit | 1 x 5 mg | 1 x 10 mg | <80 mg |
| Nefropatia diabetike (Diabeti tip 1) | 1 x 2.5 mg | 1 x 10 -20 mg | <80 mg |
| Nefropatia diabetike (Diabeti tip 2) | 1 x 2.5 mg | 1 x 10 -20 mg.* | <80 mg |

## HULUMTIMET KLINIKE PËR EFIKASITETIN E LISINOCOMP "GENERICON"

- Lisinocomp "Genericon" i administruar brenda 24 orëve të hospitalizimit pas infarktit të miokardit zvogëlon mortalitetin pas 6 javëve 30% pas 6 muajve 20% krahasuar me placebo te pacientët me diabet (IDDM dhe NIDDM)**. *(Circulation 1997;96:4239-4245. Zuanetti et al, Effect on Ace Inhibitor Lisinopril on mortality in diabetic patients with AMI).*

- ACE inkibitorët (Lisinocomp "Genericon") ngrisin tonusin parasimpatikomimetik dhe ndihmojnë në restaurimin e ekuilibrit të sistemit autonom në CHF***.

- ACE inkibitorët (Lisinocomp "Genericon") parandalojnë vazokonstriksionin koronar simpatikomimetik, përmes uljes së nivelit të angjiotenzinës 2. *(Circulation 1997;96:148-153 Intracoronary Angiotensin 2 potentiates coronary artery sympathetic vasoconstriction in Humans.)*

## Rezultatet e hulumtimit ATLAS për efikasitetin e Lisinocomp "Genericon"

### *Regjimi me dozë të lartë:*

- zvogëlon rrezikun nga vdekja ose hospitalizimi për 12 %

### *Regjimi me dozë të ulët:*

- Hipodozimi i Lisinocomp "Genericon" përgjysmon 50% shkallën e benefit terapeutik, prandaj nevojitet dozimi adekuat i këtij preparati të kombinuar.
- Preparati Lisinocomp "Genericon" (Lisinopril/HCTZ) rritë përqindjen e suksesit të mjekimit për 19% krahasur me terapinë me 2 barna Lisinopril + diuretikë (Dezii et al.)







*Doza adaptohet që shtypja diastolike të mbahet nën 90 mmHg
*IDDM - insulin-dependent diabetes mellitus; NIDDM- non–insulin-dependent diabetes mellitus
**(JACC 1993; 21:655-661. Sustained augmentation of parasympathetic tone with angiotensin converting enzyme inhibition in patients with CHF)